

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I STANDARDEVE

PROGRAM MËSIMOR PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT

LËNDA: Edukim muzikor

(klasa e nëntë)

Tiranë, 2007

1. TË PËRGJITHSHME

Edukimi muzikor në klasën e nëntë të shkollës 9-vjeçare, ka si synim plotësimin e njohurive të nxënësve për këtë grup moshor në njohjen e muzikës, përjetimin e saj dhe shprehjen e emocioneve përmes një fjalori të thjeshtë muzikor. Në këtë klasë nxënësit do të vazhdojnë të marrin njohuritë nëpërmjet linjave të këndimit, dëgjimit muzikor, luajtjes në instrument, shprehjes dhe krijimit muzikor, ku të gjitha së bashku dhe veç e veç, do të ndihmojnë nxënësit në formimin e tyre kulturor dhe muzikor me njohuri, aftësi, qëndrime dhe vlera.

Njohuritë muzikore që do të përshkruajnë programin e kësaj klase vazhdojnë të plotësojnë më tej njohuritë për muzikën e periudhës romantike e gjysmës së dytë të shekullit XVIII dhe shekullin e XIX, duke sjellë në vëmendjen e nxënësve gjinitë kryesore dhe përfaqësuesit më kryesorë të kësaj periudhe; zhvillimi i shkollave muzikore në gjysmën e dytë të shek. XIX, muzikën e shqiptare gjatë shekullit XIX dhe XX në Shqipëri si dhe gjinitë dhe përfaqësuesit kryesorë të muzikës shqiptare; zhvillimin e muzikës në shekullin XIX – XX gjinitë dhe përfaqësuesit kryesorë; muzika dhe rrymat më të zhvilluara *moderne si* bluz, xhaz, pop, rep, reggae etj.; mjetet teknike për regjistrimin e muzikës (studio të ndryshme muzikore).

Në këtë klasë nxënësit jo vetëm do të fitojnë njohuritë por do të zhvillojnë edhe një sërë veprimtarish muzikore, të cilat i aftësojnë ata në bërjen sa më mirë të këtyre veprimtarive. Në këto veprimtari përfshihen këngët, dëgjimi i pjesëve muzikore, veprimtari të cilat përfshijnë improvizimin dhe krijimin si veprimtaritë ritmike dhe harmonizimi i lëvizjeve ekspresive të trupit, luajtja me instrumentin e fyellit.

Programi mësimor i edukimit muzikor vazhdon të zhvillojë aftësitë praktike dhe aftësitë e tyre për të arsyetuar e shprehur në mënyrë kritike emocionet rreth muzikës. Ky program krijon mundësinë për të përjetuar muzikën dhe shprehur e emocionet përmes arteve të tjera si: vizatimi, poezia, vallëzimi etj.

Ky program zhvillohet në 35 javë mësimore me 2 orë në javë përgjatë gjithë vitit shkollor. Gjithashtu, në tema të veçanta muzika ka vend për t'u integruar me lëndë të tjera si *edukimin figurativ, gjuhën amtare, kiminë, edukimin fizik, historinë, gjeografinë* etj.

2. SYNIMET E LËNDËS

Programi synon të zhvillojë më tej shprehitë për të kënduar, për të dëgjuar, për të luajtur, për të krijuar, si dhe për t'u shprehur duke vlerësuar muzikën.

Mësimi i muzikës synon që nxënësi/sja në fund të klasës së nëntë:

- Të interpretojë me ndjenjë “Himnin e flamurit” ;
- Të këndojë kanone, këngë me një tematikë të larmishme, të huaja, popullore, fëmimore, me vesh dhe me nota;
- Të këndojë këngë të muzikës moderne;
- Të luaj në instrumentin e fyellit;
- Të përdorë mjetet dhe teknikat e incizimit për regjistrimin e një muzike;
- Të dëgjojë muzikë bashkëkohore të rrymave dhe periudhave të ndryshme;
- Të përjetojë muzikën duke mbajtur qëndrim ndaj saj apo lidhur atë edhe me artet e tjera.

3. LINJAT E PROGRAMIT

Ky program është i organizuar në bazë të 5 linjave të mëposhtme:

1. Këndimi,
2. Bazat e arsimimit muzikor
3. Luajtja në instrument,
4. Dëgjim muzikor,
5. Shprehje dhe krijim muzikor.

4. OBJEKTIVAT, NJOHURITË DHE AFTËSITË KRYESORE SIPAS LINJAVE

| | |
|---|---------------|
| Gjithsej | 70 orë |
| Kurrikula zyrtare | 60 orë |
| Kurrikula në dispozicion të mësuesit | 10 orë |

| Linjat | Objektivat | Konceptet dhe aftësitë kryesore | Numri i orëve sipas linjave |
|---|---|--|-----------------------------|
| <p>LINJA I.</p> <p>Këndim</p> | <p>Objektivat</p> <p>Në këtë linjë të mësohen 8-9 këngë për këtë grupmoshë, me tematikë të larmishme si këngë për atdheun, të muzikës së lehtë, popullore, moderne me një ose dy zëra, si dhe kanone. Çdo këngë dhe kanon mësohet në 2 orë dhe në disa raste në 3 orë kur është e vështirë.</p> <p>Në klasën e nëntë në këtë linjë nxënësi/sja duhet të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të interpretojë saktë dhe me ndjenjë “Himnin e Flamurit”; • të këndojë këngë tematike për këtë grupmoshë, popullore, të huaja, arie të vogla (me një ose dy zëra); • të këndojë kanone me dy zëra; • të këndojë <i>solo</i>; • të këndojë <i>në grup</i> (ansambël/kor); • të këndojë dhe të interpretojnë me ndjenjë dhe në mënyrë shprehëse 1 -2 këngë të ndryshme sipas dëshirës bluz, xhaz, pop, rep etj; • të shprehë mendimin rreth muzikës që ai/ajo këndon. | <p>ritmi,</p> <p>intonacioni,</p> <p>frymëmarrja,</p> <p>diksioni,</p> <p>interpretimi,</p> <p>këndimi solo,</p> <p>kor.</p> | <p>20 orë</p> |
| <p>LINJA II. Bazat e arsimimit muzikor</p> | <p>Objektivat</p> <p>Në klasën e nëntë në këtë linjë nxënësi/sja duhet të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të analizojë <i>rrethin e shkallëve maxhore dhe minore, me dieza</i> | <p>rrethi i shkallëve,</p> <p>trioleti,</p> | <p>6 orë</p> |

| | | | |
|---|--|---|---------------|
| | <p>dhe <i>bemola</i> duke shpjeguar rëndësinë e <i>tonalitetit</i>.</p> <ul style="list-style-type: none"> të ndërtojë dhe këndojë <i>akordet maxhore</i> dhe <i>minore</i>, duke kuptuar harmoninë e akordit; të ndërtojë ushtrime me përdorimin e <i>trioletit</i>; të shpjegojë kuptimin e <i>pentagramit të dyfishtë</i> – <i>çelsit të solit dhe të basit</i>. | pentagrami i dyfishtë | |
| LINJA III. Luajtja me instrument | <p>Objektivat</p> <p>Në klasën e nëntë në këtë linjë nxënësi/sja duhet të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> të luajë në fyell ushtrime në kohë të thjeshta; të luajë shembuj të thjeshtë për fyell (popullore); të ekzekutojë solo dhe në grup një pjesë muzikore të njohë me instrumentin e kitarës. | <p>luajtja në fyell i ritmeve të përziara dhe të thjeshta,</p> <p>ekzekutimi i një pjese të thjeshtë muzikore (popullore),</p> <p>kitara</p> | 12 orë |
| LINJA IV. Dëgjimi muzikor | <p>Objektivat</p> <p>Në klasën e nëntë në këtë linjë nxënësi/sja duhet të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> të shpjegojë zhvillimin e muzikës, <i>përfaqësuesit dhe veprat e tyre</i>, - Periudha e muzikës klasike në shek. XVII – XVIII <i>përfaqësuesit dhe veprat e tyre</i>; - Periudha e muzikës romantike në gjysmën e dytë të shekullit XVIII dhe XIX, duke studiuar dhe njohur <i>përfaqësuesit dhe veprat e tyre: (Verdi, Puçini, Vagner, Paganini, J.Shtraus, List, Shopen etj.)</i>; | <p>Muzika në shek XVII, XVIII, XIX dhe XX;</p> <p>Muzika shqiptare në shek. XIX -XX;</p> <p>Shkollat kryesore muzikore <i>ruse, flamande dhe sllave</i>,</p> <p><i>Mjetet e regjistrimit</i>,</p> | 16 orë |

| | | | |
|--|--|---|---------------------|
| | <ul style="list-style-type: none"> - Shkollat muzikore të gjysmës së dytë të shek. XIX. <i>Përfaqësuesit kryesorë.</i> - Zhvillimi i muzikës shqiptare e fundi shekullit XIX dhe përgjatë shekullit XX, duke njohur dhe studiuar <i>përfaqësuesit dhe veprat e tyre. Opera dhe baleti i parë, simfonia e parë si dhe vepra të tjera të muzikës shqiptare;</i> - Muzika në fundin e shekullit XIX dhe fillimi i shekullit XX, <i>përfaqësuesit dhe veprat e tyre, Gershvin, Debysi, Ravel, Bartok etj.:</i> - Zhvillimi i muzikës së moderne, <i>rrymat dhe përfaqësuesit kryesorë të kësaj muzike: muzika xhaz; bluz, reggae, swing (suing), pop, rok etj.</i> <ul style="list-style-type: none"> • të dëgjojë duke mbajtur qëndrim ndaj muzikës së këtyre periudhave. • të shpjegojë <i>rrugët e regjistrimit të muzikës</i>, duke shpjeguar <i>ndërtimin e një studioje muzikore dhe funksionet e saj.</i> | <p><i>studiot muzikore;</i></p> <p><i>Muzika moderne muzika xhaz, bluz, reggae, swing, pop rok etj.</i></p> | |
| <p>LINJA V. Shprehje dhe krijim muzikor</p> | <p>Objektivat</p> <p>Në klasën e nëntë në këtë linjë nxënësi/sja duhet të jetë në gjendje:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përjetojë muzikën nëpërmjet arteve të tjera: vizatim, poezi etj.; • të krijojë melodi mbi një ritëm të caktuar; • të improvizojë ritme të ndryshme nga muzika moderne; • të krijojë një <i>kolazh</i> me muzikë të gjetur nga ai/ajo vetë. | <p>interpretim, improvizim, krijim, përjetim, <i>modele</i> mbi ritme të ndryshme muzikore, kolazh muzikor.</p> | <p>6 orë</p> |

KURRIKULA E LIRË

Kurrikula e lirë (deri në 15% e sasisë totale të orëve) është lënë për t'i krijuar hapësira të nevojshme inisiativës dhe krijmtarisë së shkollës dhe të mësuesit për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe interesat e nxënësve në përputhje me objektivat e programit zyrtar të miratuar nga MASH.

Statusi i saj është sa i detyrueshëm aq edhe fleksibël. Është i detyrueshëm sepse duhen zhvilluar deri në fund të vitit shkollor. Është fleksibël sepse shpërndarja përgjatë vitit dhe mbushja me material mësimor është lënë në dorë të mësuesit në bashkëpunim me drejtorinë arsimore, drejtorinë e shkollës dhe me mësuesit e tjerë të shkollës.

Për realizimin e saj me sukses mund të përdoren burime të ndryshme, por gjithmonë të bëhet kujdes të punohet për arritjen e kërkesave të programit.

Grumbullimi i fakteve apo të dhënave të ndryshme kulturore, historike, gjeografike, demografike, mund të kthehen në një burim të vlefshëm për të organizuar orë mësimore interesante.

Organizimi i *veprimtarive artistike, vizitat në qendra të ndryshme kulturore muzikore janë në shërbim të një objektivi të caktuar të programit; organizimi i konkurseve brenda klasës; organizimi i një koncerti, biseda për kompozitorë apo artistë popullorë, lojëra të ndryshme muzikore.* Përforcimi i njohurive i shoqëruar me metoda e strategji që fuqizojnë si të nxënësit ashtu edhe mësimdhënien, janë disa veprimtari rekomanduese për rubrikën e orëve të lira.

Për mbushjen efikase të një pjese të orëve të lira mund të bashkëpunohet edhe me mësuesit e lëndëve të tjera duke hartuar paraprakisht një plan të përbashkët disa orësh që shfrytëzon lidhjet konceptuale ndërlëndore dhe aspektet kroskurrikulare. Nxënësve u jepet një detyrë e cila përfshin njohuri ndërlëndore dhe u shërbën arritjes së objektivave të programeve të disa lëndëve dhe objektivave kroskurrikulare.

Shpërndarja dhe varieteti i veprimtarive, duke ju gjetur vendin e duhur përgjatë vitit mësimor, është një element i rëndësishëm i zbatimit me sukses të rubrikës të orëve të lira.

Kujdes duhet bërë që orët e lira të mos shpërdorohen duke i shfrytëzuar për qëllime rutinë të cilat nuk sjellin risi të reja në kurrikulin shkollor.

6. INTEGRIMI

Ky program jep mundësinë që në tema të veçanta muzika të integrohet edhe me lëndë të tjera. Gjithashtu njohuritë, shkathhtësitë, qëndrimet dhe vlerat që nxënësit marrin në këtë lëndë përdoren edhe në lëndë të tjera.

Integrimi në linjën e këndimit mund të bëhet me: gjuhën amtare (duke interpretuar dhe bërë koment sipas tematikës që kanë këngët), edukimin fizik (kombinimi i lëvizjeve trupore me muzikën që ata këndojnë).

Integrimi në linjën e DM mund të bëhet me historinë (zhvillimet e muzikës pas luftës së dytë botërore), gjeografinë dhe historinë (Vendlindja e kompozitorëve të ndryshëm të muzikës) fizika (valët, tingujt, zërat) tek studiot e regjistrimit.

Integrimi në linjën e SHKM mund të bëhet me gjuhën amtare (bërja e një ese -je, edukimin fizik – përjetimi i muzikës përmes lëvizjeve ritmike).

Aspektet kros-kurrikulare janë pasur parasysh në shtjellimin e rubrikave të programit. Gjatë zbatimit të tij një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet:

- çështjeve të mjedisit, ndotjes dhe mbrojtjes së tij;
- kulturës së komunikimit (aftësimi të nxënësve për të kuptuar dhe zbatuar informacionin e shkruar në jetën e përditshme;
- mjeteve të informimit si media dhe masmedia, internetit;
- përdorimit të teknologjive të informacionit, mjeteve audio-vizive, kompjuterit;
- përdorimit të gjuhës së huaj;
- edukimit për të drejtat e njeriut;
- çështjeve të barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore, fetare;
- atdhedashurisë (informacion kulturor - artistik, ekonomik, social, historik, gjeografik);
- globalizmit.

7. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TË PROGRAMIT

Përzgjedhja e metodave mësimore bëhet nga përdoruesit e këtij programi, për të ndihmuar sa më mirë zhvillimin e procesit mësimor. Të tilla mund të jenë: konkurse muzikore, që lidhen me zhvillimin ritmik dhe melodik, me dëgjimin, verifikimin e njohurive me teste etj. Një vend shumë të rëndësishëm në organizimin e orës së mësimi ka formulimi i objektivave, si dhe zbatimi i drejtë i parimeve metodologjike të mëposhtme:

1. Edukimi i shprehive të të kënduarit. Zhvillimi i shprehive të të kënduarit do të jetë gjithmonë në qendër të punës së mësuesit/ses. Këngët, për këtë klasë do të jenë *shumë të larmishme* ku do të përfshihen edhe këngë të grupeve të ndryshme moderne muzikore. Edhe kanonet, të kënduara individualisht apo në grup, kërkojnë një përqendrim më të madh, për arsye se në to konkurrojnë së bashku tri elemente, të cilat kanë forcë shprehëse të papërshkrueshme: *vija melodike, teksti, interpretimi.*

Zbatimi i këtyre elementeve, bën që kënga të këndohet nga nxënësit jo në mënyrë formale, por në këtë nivel ajo *të interpretohet* në mënyrë shprehëse me të gjitha elementet e përmendura më sipër. Nxënësit duhet të njihen mirë me figurën poetike e muzikore të këngës që mësojnë e këndojnë. Çdo përdorues duhet t'u mësojë e të ushtrorë në mënyrë sa më të drejtë të nxënësit, të kënduarit shprehës, ku gjatë të kënduarit, ata duhet të shprehin duke interpretuar përmbajtjen dhe karakterin e këngës. Një interpretim i bukur, bëhet i mundshëm vetëm në bazë të shprehive vokale.

2. Zhvillimi i njohurive muzikore vazhdohet edhe në këtë nivel në mënyrë graduale dhe duke i transmetuar ato në një mënyrë të thjeshtë. Mësimi i këtyre njohurive nuk përbën një qëllim në vetvete, por ato janë mjeti që do t'i ndihmojë nxënësit për të kuptuar muzikën, për ta përvetësuar dhe për ta kënduar ose luajtur atë bukur dhe me muzikalitet.

Kuptimi i rrethit të shkallëve me # dhe b, kërkon vëmendje dhe kujdes për ti kuptuar. Gjithashtu njohja e pentagramit të dyfishtë bën që nxënësit të kuptojnë përdorimin dhe funksionin e pentagrameve të dyfishta.

Ushtrimet didaktike që do të shoqërojnë programin përmes tekstit të nxënësit, duhet të jenë të jenë të thjeshta, melodioze, në shërbim të temës që mësojnë.

Informacioni në vazhdim që ata do të marrin për zhvillimin e muzikës në shek. XVIII dhe XIX si dhe përfaqësuesit e tyre, do të plotësojnë formimin e tyre rreth muzikës. Ata do të njihen me muzikën shqiptare dhe zhvillimin e saj në fundin e shkullit të XIX dhe në shekullin XX.

Gjithashtu ata do të njohin dhe kuptojnë rrugët dhe mjetet e regjistrimit të muzikës në një studio muzikore. Kjo mund të bëhet duke i çuar ata në një studio regjistrimi apo duke gjetur materiale të ndryshme se si funksionon një studio. Një ndihmesë për këtë jep edhe teksti i nxënësit/es.

Në këtë klasë nxënësit do të njohin zhvillimin e muzikës moderne, të rrymave dhe grupeve më të njohura gjatë këtij zhvillimi.

3. Edukimi me instrumentin dhe loja me të. Në edukimin muzikor të nxënësve një rol të rëndësishëm luan edhe instrumenti muzikor, *fyelli*. Luajtja me këtë instrument rrit ndjeshmërinë muzikore të nxënësve, shton interesin për muzikën, ju zhvillon ndjenjën ritmike, melodike e harmonike, ju krijon ide të qarta për anën teorike e praktike të muzikës. Krahas tyre, mësuesi të ketë parasysh që nxënësit mund të praktikohen me këtë instrument nëpërmjet ushtrimeve melodike, këngësh apo melodi të thjeshta popullore. Por nuk do të mungojë dhe njohja me instrumentin e *kitarës*.

4. Edukimi i shprehive gjatë dëgjimit muzikor. Për të formuar një kulturë të drejtë muzikore nxënësve, vëmendja e mësuesit/ses përqendrohet te vlerat artistike të pjesëve të zgjedhura për dëgjim, të cilat duhet të përkojnë me periudhën në cilën është shkruar apo gjininë për të cilën flitet. Gjithashtu, këto pjesë muzikore duhet të plotësojnë kërkesat pedagogjike. Dëgjimi, si dhe kuptimi i një pjese muzikore, kërkon një përqendrim *më të madh* se ndaj një kënge. Prandaj është detyrë e përdoruesve të programit që këto vështirësi t'ua lehtësojë nxënësve, duke i drejtuar për një dëgjim sa më të drejtë, duke i kthyer ata në dëgjues të aftë për të ndjekur muzikën e çdo gjinie qoftë ajo, duke i aftësuar ata për të mbajtur qëndrim ndaj muzikës dhe duke u shprehur me fjalë të thjeshta.

Për zhvillimin e kësaj ore, një rol të rëndësishëm kanë edhe mjetet didaktike mësimore që mundësojnë zbatimin me sukses të dëgjimit muzikor. Dëgjimet muzikore, të shoqëruara me *shpjegime* dhe *biseda*, kanë rëndësi të madhe, sepse shtojnë më tej dhe përforcojnë njohuritë e muzikës. Një rëndësi shumë të madhe ka edhe përdorimi i pajisjeve si: TV, Video apo DVD. Kjo bën që të zhvillohen te fëmijët elemente të emocioneve estetike, një nga shfaqjet e para të të cilave është kënaqësia që provojnë kur dëgjojnë gjini si: opera, baletë etj.

8. VLERËSIMI

Vlerësimi i nxënësve në këtë lëndë të bëhet përmes përfundimeve që arrin nxënësi/sja gjatë veprimtarisë praktike, d.m.th. përmes të kënduarit, të luajturit, të analizuarit të pjesëve muzikore etj. Vlerësimi bëhet në atë çka nxënësi ka përvetësuar dhe është i aftë të bëjë. Verifikimi i njohurive të nxënësve mund të bëhet edhe me anë të *testimit*, e cila, është një nga teknikat e vlerësimit. Testi ka rëndësi për të parë qëndrueshmërinë e dijeve të marra, si dhe nxjerrjen në pah të aftësive në të gjitha linjat. Testi mund të ndërtohet me pyetje me përgjigje alternative apo dhe me shtjellim. Një ndihmë në zhvillimin e testeve japin *dëgjimi i kasetave, fjalëkryqet, verifikojmë njohuritë* etj.